### 3.3.4. Guzhina

Guzhina shqipëtare është e ndikuar shumë nga ajo turke: ndër gatimet më të përhapura janë *shishqebap* (kryesisht mish i pjekur ne zgarë), *romstek* (gatime me mish të grirë) dhe *qoftet*. Është një guzhinë e thjeshtë por që bëhet më e shijëshme nga një sasi e madhe erëzash. Disa pjetanca janë shumë të veçanta, : ndër to *dromesat* (makarona te bera me kokrra mielli qe gatohen ne nje gjelle), *tridhelat* (makarona të bëra në shtëpi, që shoqërohen me fasule) dhe *byreku*.

Mishi i vëçit përdoret shumë, por përdoret edhe mishi i kecit dhe i qingjit. Ndër gatimet karakteristike janë *çomleku* (me mish dhe qepë), *fërgesa* (*djadhe*, *gjize*, *domate me specat e ferguar*), *rosto me salcë kosi* (*rosto me ajken e kosit*) dhe *tavë kosi* (mish qingji me kos). Shumë të shijëshme janë edhe zarzavatet e skuqura si *vezë petull* me rradhiqe ( fergese me rradhiqe, me llopsana dhe kaperi), *minzetra me ullinj dhe bathë* (*fergese me bath te thata dhe ullinj*).

Traditave të lashta i përshtaten *djathërat* si djathi i bardhë i deles, *filicat*, *gjiza* etj.

Të shijëshme janë *kanarikujt* (myfle me mjaltë), *casolle me gjizë* (*embelsire e mbushur me gjize*), *kulaçi*, *petullat*, dhe *nuçia*, që ka formën e njeriut me një vezë, në vend të fytyrës.

Përveç verës (e bardha është më e mirë) të tjera pije alkoolike tipike janë *rakia*, *konjaku*, *uzo* etj.

Shumë përdoret kafeja që mund t'a gjesh si *kafë turke* ose *kafë ekspres*.



Pjetanca tipike te guzhines shqiperare

## 4 Komuniteti dhe jeta shoqërore.

### 4.1. Festat nacionale

Festat kombëtare në Shqipëri janë shumë duke qënë një vend me një histori të gjatë dhe të vështirë ku data të ndryshme janë zgjedhur për të përfaqësuar dhe kujtuar momentet dhe ngjarjet historike dhe politike domethënëse të Shqipërisë. Plus kësaj në Shqipëri festohen edhe shumë festa fetare nazionale (duke qënë një vend me 4 fe të ndryshme) në të cilat merr pjesë i gjithë populli që karakterizohet nga një tolerancë e dukëshme fetare. Festat në Shqipëri mund të ndahen në tre grupe.

#### Festat me data fikse

**1 dhe 2 Janari:** ditët festive të vitit të ri. Zakonisht në këto dy ditë bëjnë dhe presin vizita të afërmëve më të ngushtë dhe miqve më të dashur. Miqtë gostitën me ëmbëlsirën tipike të Ballkanit (që në Shqipëri përdoret vetëm në vitin e ri) që quhet bakllava që bëhet nga shumë shtresa petash të holla të bëra me dorë dhe disa shtresa arrash të shtypura. Pasi piqet në furë sherbetoset me sherbet.

**7 Marsi:** Dita e mësuesve. Kjo ditë kujton hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë. Zakonisht nxënësit i dhurojnë mësuesve të tyre buqeta lulësh dhe japin shfaqje për nder të tyre.

**8 Marsi:** Dita e gruas. Bëhet në ditën internacionale të grave por është edhe dita e nënës. Bashkëshortët dhe fëmijët i dhurojnë diçka simbolike gruas dhe nënës, dhe zakonisht hanë drekë



Baklava, embelsire tipike e festave te vitit te ri



14 mars, koncert i madh ne shesh per ditën e verës

jashtë. Shumë e përhapur në këtë ditë ishte zakoni i piknikut familjar traditë kjo që tani po i lë vëndin drekës në restorant.

**14 Marsi:** Dita e pranverës(ose dita e verës). Festë me origjinë pagane, shumë e dëgjuar në të gjithë Shqipërinë por mbi të gjitha në Shqipërinë qendrore dhe në mënyrë të veçantë në Elbasan. Festohet në fushë nën rrezet e para të diellit pranveror. Të famshëm janë piknikët në fushat rreth Elbasanit, ku mbledhen familje nga gjithë Shqipëria. Embëlsira tipike e festës janë ballokumet të bëra në shtëpi vetëm nga familjet e Elbasanit ose me origjinë nga Elbasani.

**22 Marsi:** Dita e Nevruzit. Në këtë ditë festohet profeti Nevruz që është krijuesi i besimit Bektashi. Festohet mbi të gjithë nga komuniteti Bektashian që me këtë rast bën dreka dhe bankete publike. Embëlsira tipike e festës është hashureja që bëhet me grurë të zier sheqer dhe niseshte.

**1 Maj:** Dita e punëtorëve. Edhe kjo festë bëhet në ditën tradicionale të punëtorëve. Gjatë komunizmit festohej me parada të mëdha nga klasa punëtore që parakalonte përpara diktatorit që përshëndeste nga tribuna, ndërsa tani paradat ja kanë lënë vëndin protestave në shesh të organizuara nga sindakatat për përmirësimin e kushteve të punëtorëve.

**5 Maj:** Dita e dëshmorëve të luftës së dytë botërore. Në këtë ditë kujtohet vrasja , nga fashistët, e komunistit Qemal Stafa, një nga themeluesit e Partisë komuniste shqiptare; kujtohen gjithashtu të gjithë ata që gjatë luftës së dytë botërore dhanë jetën e tyre për çlirimin nga nazi-fashizmi.

**19 Tetor:** Dita e nënë Terezës: festë e vendosur pas rënies së komunizmit, por shumë e dëgjuar nga populli shqiptar duke qenë madre Teresa di Kalkuta, shqiptare dhe bijë e një familje shqiptare, që bënte pjesë në komunitetin shqiptar të Maqedonisë.

**28 Nëntori:** Dita e flamurit. Kujtohet dita e shpalljes së parvërsisë së Shqipërisë nga perandoria turche-otomane duke ngritur flamurin shqiptar në mesin e sheshit të qytetit të Vlorës, sot quhet "sheshi i flamurit". Festohet me festime të mëdha në shesh dhe me koncerte të ndryshme muzikore në të cilat marrin pjesë shumë të rinj. Paradat ushtarake të komunizmit tani i kanë lënë vëndin të quajturave "netë të bardha" që vazhdojnë edhe më 29 Nëntor, duke festuar në këtë mënyrë edhe ditën e çlirimit nga pushtuesit nazi-fashist të luftës së dytë botërore.

**29 Nëntori:** Dita e çlirimit nga okupatorët nazi-fashist. Festohet në të njëjtën mënyrë të ditës së më parshme.

**25 Dhjetori:** Dita e Krishtlindjeve. Edhe kjo festë e vendosur mbas komunizmit. Festohet me pak bujë sepse nuk ka tradicione fetare të forta. Përveç festës në shtëpi, me drekën në familje, të rinjtë marrin shpesh pjesë në meshën e mesnatës ndërmjet 24 dhe 25 dhjetorit. Megjithatë më shumë se festë fetare është një rast për tu argëtuar jashtë deri vonë. Është një traditë e marrë nga Perëndimi, sidomos nga Italia të cilën të gjithë të rinjtë e ndjekin.



Monument per pavarësinë ne sheshin e flamurit ne Vlore

### Festa me data të ndryshueshme

**Dita e parë e Ramazanit.** Dita në të cilën festohet hapja e muajit të pastrimit për myslymanët domethënë Ramazanit.

**Bajrami Vogël** (mbyllja e muajit të Ramazanit). Ditë në të cilën festohet mbyllja e muajit të Ramazanit. Për këtë rast shtrohen bankete të mëdha publike për besimtarët që dëshirojnë të marrin pjesë.

**Pashkët katolike.** Ditë në të cilën kujtohet vdekja dhe ringjallja e Krishtit.

**Pashkët ortodokse.** Ditë në të cilën kujtohet vdekja dhe ringjallja e Krishtit. Një zakon i veçantë, si për katolikët ashtu dhe për ortodoksët është lyerja në të kuqe e vezëve të ziera që pastaj i dhurohen njerëzve që vijnë për vizita në shtëpi për këtë festë. Është zakon që një vezë të ruhet në shtëpi deri në Pashkët e ardhëshme kur do të zëvendësohet nga veza e re.

**Bajrami i Madh** ose Festa e Sacrifikimit. Në këtë ditë myslymanët i dhurojnë Zotit sacrificën e tyre duke therur një qingj, mishi i të cilit i shpërndahet familjeve nevojtare dhe në vështirësi që nuk mundin të blejnë ose të sacrificojnë një qingj.

### Festat me data jo zyrtare

Në këtë grup, hynë festat jo të njohura ose të njohura jo plotësisht nga kalendarit zyrtar shtetëror si psh. ditët e festave të lidhura me besime popullore që kanë prejardhje pagane edhe pse kanë emra festash kristiane ose myslymane si psh. dita e Shën Gjergjit, dita në të cilën fillohet punimi i tokës mbas dimrit; e quajtura “nata e mirë” e llogaritur sipas kalendarit hënor arab myslyman që në besimin kolektiv duhet të ishin netët në të cilat vendodhja e veçantë e planeteve dhe e yjeve favorizonte kryerjen e mrekullirave dhe të dëshirave (zakonisht festohet në rrethin familjar, në familjet myslymane ose në ato të përziera me burrin ose gruan myslymane, duke përgatitur një ëmbëlsirë tipike dhe të shpejtë, hallvën, me bazë ujë, vaj, miell dhe sheqer).

Ndër të tjera çdo qytet feston ditën e vet të çlirimit nga okupatorët. Për tu kujtuar janë dhe festat që bëhen me rastet e përvjetoreve të lindjes ose të vdekjes të një heroi kombëtar ose e një poeti apo të tjerë personazhe historik që kanë bërë shumë për vëndin e tyre.

#### 4.2. Veshjet dhe kostumet kombëtare

Kostumet kombëtare, që janë të ndryshëm në zonat e ndryshme, nga jugu në veri, tashmë nuk përdoren më në Shqipëri. E gjithë popullsia vishet në mënyrë evropjane dhe mbi të gjithë adoleshentët dhe të rinjtë që njekin modën e anës tjetër të Adriatikut. Vetëm nëpër fshatra gratë e vjetra vazhdojnë të veshin veshje të gjëra dhe të errëta me shamia mbi flokë që bazohen tek veshjet e vjetra. Shumë të rralla janë në Shqipëri gratë myslymane që mbajnë “çarçaf”. Zakonisht në familjet shqipëtare kur hynë në shtëpi hiqen këpucët dhe përdoren pandoflat. Ndoshta si një kujtim i zakoneve të vjetra, është shumë e rrënjosur në Shqipëri përdorimi i “kostumit të mirë” për gratë dhe “kostumit të ri” për burrat, veshje që përdoren vetëm në raste të mëdha si dasmat, pagëzimet, festat fetare etj.

#### 4.3 Seksi

Seksi, përpara ishte një tabu (aq shumë i rrënjosur sa që edhe në saj të ndryshimeve shoqërore dhe kulture të bëra nga komunizmi, nuk u ndryshua), tani, megjithë vështirësitë e shumta, në qytetet e mëdha, po bëhet një argument për të cilin mund të flitet lirisht. Në shkollat tetëvjeçare dhe të mesme është futur edukacioni seksual.



Busti për njëqindvjeçarin e vdekjes  
Te heroit nacional Scanderbeg



Gratë e zonave bujqësore

Regullat morale që rregullojnë seksin në Shqipëri, në përgjithësi nuk janë fetare, por rrjedhin nga normat etike të shoqërisë. Tradicionalisht, në përputhje me normat shoqërore, vajzat dhe djemt nuk kanë shumë raste për tu njohur me seksin e kundert, përpara martesës, sepse edhe pse kjo nuk është e plotësisht e ndaluar, është në një farë mënyre jo e lejuar sidomos në zonat fshatare. Aty akoma vajzat 15-16 vjeçe fejohej (nga familjet apo edhe me lejen e tyre) dhe mbas një kohe të shkurtër martohen.

Pas ardhjes së demokracisë, rregullat shoqërore mbi seksualitetin, janë liberalizuar mbi të gjitha në qytetet e mëdha. Moshë e martesës se të rinjve është ngritur shumë.

Megjithëse shikimi i përgjithshëm mbi seksualiteti eteroseksual është duke ndërruar drejtë modelit perëndimor, homoseksualiteti nuk shihet me sy të mirë, përkundrazi është i dënues nga ligjet morale dhe shoqërore shqiptare. Për shkak të të ashtuquajturit “burrë i fortë”, të quash dikë homoseksual në Shqipëri, është një ofezë e rëndë. Shpesh homoseksualët janë të detyruar të transferohen në qytete të mëdha ose të emigrojnë jashtë për ti shpëtuar paragjytimeve të shoqërisë.



Te rinj shqiptare

#### 4.4. Dhuna shtëpiake



Gra të keqtrajtuara të ndihmuara nga një NGO për femra të rrethit që festojnë fundin e kursit profesional që do ti bëjë të pavarura ekonomikisht

Shqipëria është një nga vendet evropjane me treguesin më të lartë të dhunës shtëpiake edhe se njihet pak nga opinioni shoqëror që godet më shumë gratë dhe fëmijët. Por janë pak gratë që denuncojnë dhunën qoftë, për të mos prishur familjet dhe për të mirën e fëmijëve, por edhe se mungesa e një pune të sigurtë dhe e banesës, e detyrojnë gruan të rri me burrin violent. Ndër të tjera edhe kur gruaja e denunçon dhunën, haset në pengesa të shumta sepse e drejta bazë e gruas që të jetë e lirë nga dhuna, nuk mbrohet siç duhet nga sistemi gjyqësor. Në raste e pakta kur arrihet një vendim i fajësisë, fajtori dënohet me një gjobë, gati asnjëherë me

burg.

Nga ana tjetër edhe gruaja nuk i ka të qarta të drejtat brënda familjes. Në Shqipëri nuk ka ligje të caktuara mbi violencën shtëpiake. Disa organizata femërore kërkojnë ta ngrënë problemin, nga një anë duke informuar opinionin shoqëror dhe nga ana tjetër duke ngritur qëndra për dëgjim dhe asistencën e viktimave të dhunës.

Është i rëndësishëm fakti që si bazë e trafikut të grave dhe fëmijëve, shpesh është një histori e dhunës shtëpiake, e keqtrajtimit dhe të abuzimeve seksuale.

#### 4.5. Alkolizmi

Alkolizmi është shumë i përhapur në Shqipëri edhe ndër të rinjtë. Pijet alkolike më të preferuara janë rakija, birra dhe vera. Më shumë të prodhimet të brëndshëm edhe shtëpiak.

Shkaqet më të shpeshta që çojnë në abuzimet alkolike janë problemet e tipit ekonomik dhe familjar, si edhe stresi në punë. Abuzimi i alkolit në moshë të re dhe shumë të re (që shpesh shoqërohet me përdorimin e drogave) shpesh i ka motivet në familje dhe në shkollë. Nga ana tjetër abuzimi i alkolit është shkaku kryesor i dhunës në familjet shqiptare dhe shpesh shkak i ndarjeve.

Sipas autoriteteve sanitare pjesa më e madhe e krimeve që bëhen në rrethin familjar, është e lidhur me dehjen e personave që i bëjnë, si edhe një pjesë e madhe e aksidenteve rrugore ndodh për shkak të alkolit nga ana e shoferëve.

#### 4.6. Kushtet e jetës së gruas



Lek Dukagjini, princ i veriut,  
autor i ligjit konsuetudinar të  
Kanunit

Në Shqipërinë e paraluftës dhe në mënyre të veçantë në malësinë e veriut, kushtet e jetës së gruas ishin rregulluara me ligj nga ligji i Lekë Dukagjinit që në artikullin 29 thotë që: “Gruaja është një send i bërë vetëm që të vuaj: një send i vogël që duron peshë dhe mundime”. Gjithashtu duke nënvizuar artikullin 20 “Gruaja është një gjë e tepërt në familje...”. “Nuk ka asnjë trashgimi nga të afërmit e sajë, as nga shtëpia as nga prona të tjera”, artikulli 31: “nuk ka të drejtë të zgjedhi burrin” dhe artikulli 34: “nuk ka të drejta mbi fëmijët as mbi shtëpinë”. Në rast të pabesisë ndaj burrit “...burri e vret gruan dhe nuk është i përndjekur nga asnjë shpagim”<sup>6</sup>.

Vetëm regjimi i E.H. në një farë mënyre i hoqi këto zakone duke lejuar gruan të futej në politikë dhe në punë, deri në njohjen formale të barazisë dhe të të drejtave dhe detyrave të vendosura në Kodin e Familjes të 1982.

Mbas rënjes së komunizmit, papunësia e përgjithëshme e tranzicionit të ekonomisë dhe të tregut, që ka goditur mbi të gjitha gratë punonjëse, nuk ka favorizuar këtë proces të emancipimit të gruas. Sipas të dhënave të 2004, në profilin e zënies së roleve drejtuese dhe profesionale, hendeku ndërmjet sekseve është akoma shumë i gjërë<sup>7</sup> dhe sa për jetën politike, pjesëmarrja aktive e gruas është shumë e pakët. Megjithatë gratë në parlamentin shqipëtar përfaqsohen pakë, është krijuar një grup parlamentar femërorë që ka paraqitur një dokument për të përmirësuar kushtet e punës së gruas, që është përfshirë në Kodin e Ri të Punës dhe në Kodin e Ri të Familjes. Më domethënëse është pjesëmarrja e gruas në Organizatat jo Shoqërore ndër të cilat llogariten më shumë se 25.

Si përfundim, nën profilin formal dhe juridik, gratë shqipëtare kanë arritur një gradë të emancipimit, e krahasueshme me atë të vëndeve përendimore, por në realitet ngelin sjellje dhe nivele të pjesëmarrjes në jetën shoqërore, të ndryshme ndërmjet burrave dhe grave. Gruaja shqipëtare jeton akoma sipas “modelit tradicional” në të cilin roli i sajë në shoqëri ka fuqitë e sajë dhe poshtë burrit dhe është nën urdhrat e tij. Është e qartë që disa shenja të ligjit të vjetër të Kanunit jetojnë akoma në Shqipërinë e sotme, mbi të gjitha në zonat fshatare dhe në qendrat e vogla.



Te reja shqiptare

#### 4.7. Trafiku njerëzorë

Ndryshimet rrënjësore shoqërore, ekonomike pas komuniste kanë bërë që Shqipëria të përballojë fenomene shoqërore të pa njohura më parë, ndër të cilat ai dramatik i trafikut të qënieve njerëzore në veçanti qëllimin e prostitucionit. Mund të themi që kultura patriarkale e vëndit, që nuk ngjall respekt për të drejtat e gruas, është baza e këtij trafiku.

Qytetet e Shqipërisë më të interesuara në trafikun e grave janë ai i Beratit, Fierit, Shijakut, Laçit, Vlorës të gjithë ndodhen në pjesën perëndimore të vëndit, në të cilin është më i lehtë transferimi për në Itali. Ka edhe zona në të cilat është më i përhapur trafiku i drogës, armëve dhe e klandestinëve. Gratë, viktima të trafikut, janë vajzat e varfëra të periferive ose të qyteteve të vogla, që kanë pasur fëmijëri të vështirë dhe shpesh kanë pësuar violencë fizike ose dhunë seksuale nga familjarët.

Vetëm në Janar 2001 u aprovua në Shqipëri, ligji që quan krim penal trafikun e personave, ndër të cilët ai i grave për qëllim prostitucioni dhe ai i fëmijëve. Qeveria Shqipëtare ka formuluar “Strategjinë kombëtare të luftës kundër trafikeve ilegale të njerëzve”.

<sup>6</sup> Gjecov S.C., Codice di Lek Dukagjini Kodi konsuetudinar i maleve të Shqipërisë, Reale Accademia d'Italia, 1941.


<sup>7</sup> Sipas të dhënave UNICEF të 2004 janë gra 28% të profesoreve të universitetit, 21% të gjykatësve, 14% të avokateve dhe 22% të mjekëve.

Ndër organizatat që veprojnë në mbështetje të viktimave të trafikut të qenjeve njerzore, përveç agjensive të O.K.B. është edhe Organizata Internazionale e Emigrimit, e vetmja me personel të specializuar, e aftë të veprojnë në të gjithë territorin kombëtar. Ndër organizatat jo qeveritare të huaja është Save the Children (shpëtoni fëmijët) që vepron për një projekt, së bashku me Qendrën e ndihmës për vajzat e trafikuar në Vlorë.

#### 4.8. Të vjetrit

Sa për të vjetrit, ka institute për kujdesin e pleqëve, të drejtuara nga shteti dhe nga fondacionet dhe organizatat pa qëllim fitimi, por edhe nga privatët, me pagesë. Një përqindje e lartë e të vjetërve ka patologji mendore dhe më e përhapura është demenca. Kjo për shkak të një asistence mjekësore të pa mjaftueshme për të vjetrit.

Me gjithë atë, pjesa më e madhe e pleqve rri në familjen e djalit më të vogël, i cili trashëgon edhe shtëpinë e prindërve. Kjo ndodhë për shkak të konceptit të familjes së zgjeruar, që karakterizonte familjen shqipëtare ca vjet më parë, por edhe nga kushtet ekonomike të pensionistëve, shumë të vështira dhe vështirësitë e të rinjve për të pasur një shtëpi të tyre.



*Burr i moshuar*

#### 4.9 Ceremonitë e vdekjes

Ceremonitë e vdekjes në Shqipëri, ruajn akoma sot, traditat e riteve mesjetare. Kur vdes dikush, bëhet ruajtja ose përgjimi i të vdekurit, të paktën një natë, gjatë të cilës, të afërmit qajnë me zë të lartë dhe me vaje vdekje dhe përgjojnë mbi trupin e të vdekurit; zakonisht në mëngjesin e ditës së ardhshme, shtëpia e të vdekurit rri e hapur për të pritur ngushëllimet dhe vizitat e të afërmeve dhe miqve, të cilët shoqërojnë në orët e para të pasdites, të vdekurin në varreza duke krijuar kështu një kortezh. Pasi i vdekuri varroset, është detyrë e familjarëve të tijë, të organizojnë një drekë për nder të të vdekurit (një lloj banketi vdekje). Zakonisht familja izohet për një periudhë zije, e shprehur dukshëm nga gratë e familjes, të cilat vishen në të zeza dhe nuk lyhen. Sa zgjat zija varet nga afërsia fisnore me të vdekurin, zakonisht zgjat 40 ditë për njerëzit e largët dhe burrat, por shpesh për gratë në moshë të vjetër, që u vdes burri dhe nënat që humbin bijtë, nuk mbaron kurrë.

### 5. Familja dhe shoqëria

#### 5.1. Përbërja familjare

Aspekt i rëndësishëm, i përbërjes familjare, është mesatarja e pjestarëve për familje. Familja shqipëtare, nga disa dhjetvjeçarë po eksperimenton një kalim nga një lloj familje e zgjeruar dhe me disa bashkësi, tipike e shoqërive tradicionale fshatare, në një familje të vetëme që i përshtatet kushteve të jetës të një stili “modern”, frut mbi të gjitha i ndryshimeve të detyruara nga regjimi komunist në strukturën shoqërore-ekonomike të vendit nëpërmjet programit të industrializimit të detyruar. Shpërndarja e punëtorve të sektorit të punës së krahut dhe e popullsisë qytetare bëri që të prishej familja e zgjeruar. Përbërja e familjes shqipëtare ndryshoi pak nga vitet '50 deri sot: nga një me satare 5,8 anëtar në 1950, e cila u ruajt deri në fund të viteve '70, arriti në 1989 dhe në më pak se 4 më 2003.

Meqenëse çiftet bëjnë më pak fëmijë faktorët ekonomik si mungesa e banesave, të ardhurat e pakta familjare dhe zgjatja e jetës, kanë bërë shpesh të nevojshëm bashkëjetesën e disa brezave (gjyshër, prindër, bij, këta të fundit edhe të martuar dhe me fëmijë), duke ekuilibruar



*Familja shqipetare*

rënien e përqindjes të shtimit, dhe duke ngadalësuar kalimin drejt familjes me pak pjestarë. Domethënëse janë familjet me 1 person që vijnë në zbritje, duke kaluar nga 6,1 në 4,2 % të numrit të përgjithshëm të familjeve, ndërsa familjet me 4-6 persona shtohen nga 41,3 në 55,2 %.

Ajo që duket dhe në nivelin e përbërjes familjare, është karakteri i dukshëm fshatar i pasluftës: më 1950, 80% e popullsisë ishte fshatare, gjë që kuptoet duke pasur parasysh që deri në fund të luftës së dytë botërore, Shqipëria nuk ka njohur industrializimin (vetëm në formë embrionale), dhe latifondizmi ka përfaqësuar të vetmin model shoqëror dhe teritorial.

## 5.2. Lindjet dhe vdekjet

Duke analizuar përqindjet e lindjeve dhe të vdekjeve në vitet e regjistrimeve të përgjithëshme (vitet '50, '60, '80, '90) dalin në pah dy drejtime të caktuara që gjejnë takim në ecurinë e popullsisë së përgjithëshme dhe sqarojnë dinamikën e brëndëshme: përqindja e lindshmërisë (e kuptuar si numër i lindjeve në çdo 1000 banor) pëson së pari një ngritje ndërmjet 1950 (38,5) dhe 1960, vit në të cilin arrin vlerat më të larta në 43,3, për të rënë më vonë në mënyrë kostante deri në vlerën 25,2 më 1990; flitet për një rënie relative të vogël, po të konsiderojmë që nga 1950 deri më 1990, përqindja zvogëlohet 34,5%. Nga 1990 konstatohet një rënie tjetër e lindjeve që vjen nga emigracioni masiv i popullsisë në moshë për lindje, një rritje e moshës mesatare të martesave si për femrat ashtu dhe për meshkujt, nga përdorimi i metodave të planifikimit familjar. Nga 2000 kur ishte 19,47 lindje për 1000 banorë në 2004 dhe në 2005 zbriti në 15,08 për 1000 banorë. Në mënyrë të ngjashme edhe koeficienti i lindshmërisë ishte pakë më shumë se 2 të lindur për grua, ndërsa më 2000 ishte 2,37 i lindur/grua<sup>8</sup>.

Përqindja e vdekshmërisë (e kuptuar si numër i vdekjeve për 1000 banor), ka pasur një rënie domethënëse (60%) duke kaluar nga 14 më 1950, në 5,6 më 1990. Sipas të dhenash të tjera, përqindja e vdekshmërisë nga 2000 ka rënë progresivisht nga 6,5 të vdekur çdo banorë, në 5,02 më 2004, pastaj tregon një ngritje të lehtë më 2005 (5,12). Edhe vdekshmëria e fëmijëve ka pas zbritur në mënyrë progresive nga 51,43 të vdekur, çdo 1000 të lindur gjallë më 2000, në 21,52 më 2005.

Me kuptimin e moshës mesatare të vdekjes, Shqipëria ka regjistruar përparime të dukshme nga çlirimi deri më sot: nga një shpresë për të jetuar nga lindja deri në 50,4 për meshkujt dhe 49,5 për femrat më 1950, ka kaluar më 1995, respektivisht në 68,5 dhe 74,3 vjeç, me një mesatare mbi 71 vjeç për popullsinë në përgjithësi. Në pesë vjetët e fundit ka kaluar nga 71,57 vjeç më 2000, në 77,24 më 2005. Për 2006 është vlerësuar 77,43 vjeç (74,78 në meshkujt dhe 80,34 në femrat), vlerë e afërt me atë të vendeve të industrializuara.

## 5.3. Martesat

Martesa në Shqipëri, është akoma një institucion shumë i fortë edhe se në këto vitet e fundit është shtuar numri i çiftëve (kryesisht në qytetet e mëdha si Tirana) që zgjedhin bashkëjetesën, për të vendosur më vonë për martesë. Këta vite të tranzicionit që Shqipëria është duke kaluar, kanë influencuar edhe mbi moshën e martesës. Edhe se rritja e moshës mesatare të martesës, çon në përgjithësi në formimin e familjeve më të qëndrueshme dhe të forta, numri i ndarjeve për çdo njëqind martesa është shtuar nga 9,6 më 2001 në 14,2 më 2004, por kjo spjegohet edhe me përmirësimin e kushteve të femrës, duke qënë pjesa më e madhe e kërkesave për ndarje e bërë nga gratë. Nga 1990 është rritur në mënyrë progresive edhe moshja mesatare e çiftëve që bashkohen në martesë, moshë që tashmë ka arritur nivelet europiane.

Celebrimi më i shpeshtë i ritit të martesës është ai laik, qoftë sepse shqipëtarët nuk janë besimtar, ashtu dhe për numrin e lartë të martesave të përziera. Normalisht kalohet në martesë



Martese laike

<sup>8</sup> CIA World Factbook, 2005; www.indexmundi.com

mbas një perjudhe fejese që duhet ti shërbejë dy të fejuarve për t'u njohur, por faza e fejeses është e konsideruar si një ligj i vërtetë nga i cili nuk mund shkëputen duke prishur fejesën. Ky realitet përdoret më shumë në zonat fshatare dhe qytetet e vogla ku fejesa bëhet zyrtare me lejen e të dyja familjeve të të rinjve. Gjithëmonë në qytetet e vogla dhe në zonat fshatare, është shumë e përhapur martesë në moshë të re, ku shihen të fejuara vajzat por edhe djemt që në moshën 16 vjeç dhe të martuar me fëmijë në moshën 18 vjeç. Shpesh ka raste në të cilat vajza martohet nga familja edhe kur është 14 - 15 vjeçe.

#### 5.4. Marrëdhëniet ndërmjet brezave

Në Shqipëri ekziston një rrespekt i madh ndaj pleqëve që janë parë si shtylla të autoritetit të zgjuarsisë dhe të njohjes. Në zonat fshatare pushteti më i lartë, është përfaqësuar gjithëmonë nga këshilli i pleqëve me në krye figurën e Kryeplakut. Kaq i fortë është ky zakon, që tashmë është bërë ligj. Ndryshe shkojnë punët në qytetet e mëdha ku në këtë perjudhë plot me ndryshime shoqërore, autoriteti i pleqëve është duke rënë, edhe për shkak të vështirësive të brezave të vjetër për të kuptuar dhe për të pranuar “gjërat e reja” që ka sjellë hapja drejt botës perëndimore. Nga ana tjetër popullsia shqipëtare është shumë e re dhe reformat për modernizimin e shoqërisë, të futura si gjatë komunizmit, ashtu dhe më vonë, i kanë dhënë shumë rëndësi shoqërore të rinjve, të konsideruar e ardhmja e vëndit.



*Gra te moshuara ne park*

## 6. Shendet, arsimit, puna

### 6.1. Shendet

Nga te dhenat me alarmante per sa i perket konditave te shendetit te popullsesise shqiptetare eshte vdekja infantile, qe rezulton doppio me mesataren e UE dhe fakti qe ushqimi dhe uji jane te infektuar jane origina e semundjeve infektive.

Tek servisi sanitar, gjeja qe godet pernjehere kur analizon statistikat, eshte renia e forte nje ndodhi midis 1990 dhe 1993 me numrin e spitaleve, reparteve te lindjes dhe vendeve shtrat. Kjo renie ndaloi ne vitet me pas dhe nga 1995 filloi te nderronte tendence. Mjaft e larte eshte dotacioni me personal mjekesor, por sensibilisht i ulet duke i krahasuar me standardet europian.

Megjitate punetoret sanitar jane te pamjaftueshem dhe livelet e shpenzimeve jane shume te ulet. Sipas Oms, eshte nevoja e nje rregullimi koordinacioni dhe nje strukturizim me te madh te sistemit sanitar.

Ne traditen shqiptetare shte shume e perdorur mjeksia popullore, kaluar brez pas brezi; ajo ka zhvilluar nje rrol te rëndesishem, mbitegjitha perpara regjimit komunist, per te sheruar shume semundje. Per kete Shqiptetaret perdorin nje gojedhene te vjeter: “per çdo semundje ekziston nje bime qe e sheron, dhe çdo bime duhet per te sheruar nje semundje.” Ne Zadrime dhe ne pjese te tjera te vendit, rriten shume lloje bimesh mjeksore te ndihmuara nga ndryshimi i konditave gjeografike, altimetrie, klimatike dhe podologjike te terrenit. Kjo tradite, e perhapur dhe ne fshatet dhe ne qytete, ka mbajtur gjalle akoma sot pozitivitetin e saj dhe eshte e thjeshte te gesh ne shtepite e shume familieve shqiptetare, kamomilin, rigonin, hudhren, qepen, vajin esencial te iperikos dhe shume bime te tjera qe perdoren per te sheruar semundjet e aparatit fryme-marres, aparatit tretes dhe shume plaga.

### 6.2. Kultura dhe edukimi

Sistemi kulturor tradicional shqipëtarë, perplasit me ndryshimet e tanishme në mënyrën e të jetuarit të familjeve: vërsimi nga fshatrat drejt qyteteve të mëdha, shtimi i numrit të divorceve, emigracioni jashtë shtetit. Në këtë gjëndje shoqërore të paqëndrueshme, fëmijët dhe adoleshentët janë më të dobët, duke qënë shpesh të braktisur në vetvete.

Të rinjtë kanë si të vetme mënyrë argëtimi sallat e bilardos dhe lokalet, ku kalojnë ditën duke pirë pije alkoolike, duhan dhe shpesh duke u zirë ndermjet tyre. Ndërsa vajzat që në moshën trembëdhjetë vjeçare janë të detyruara të rrinë në shtëpi dhe të kujdesen për vëllezërit më të vegjël dhe punët e shtëpisë, në pritje të martesës shpesh e vendosur nga prindërit. Praktikisht adoleshentëve nuk i lejohet të jetojnë moshën e vetë. Përgjegjësitë më të mëdha të rritjes dhe edukimit të fëmijëve, bien mbi nënat.

Edukacioni i familjes gati nuk ekziston, shprehjet e dashurisë janë gati nuk ekzistojnë; fëmijët rriten pa asnjë rregull, të hutuar dhe të ç' orjentuar. Mungojnë njohuritë si në nivelin familjar (njohuritë e të drejtave të fëmijëve, të edukimit ushqimor dhe rregullat higjienike-sanitare dhe të alfabetizimit), ashtu dhe në nivelin civil (njohja e të drejtave dhe të detyrave, përgjegjësia dhe pjesëmarrja në jetën shoqërore, sensi i pjesëmarrjes dhe i detyrave për iniciativat komunitare); baballarët nuk marrin pjesë fare në ciklin edukativ të fëmijëve dhe shpesh mungojnë fare në jetën e fëmijëve.

Përsa i përket arsimit, regjimi komunist ka investuar në sistemin shkollor një sasi të madhe të burimeve, duke i lejuar shqipëtarëve të arrijnë, në vitet tetëdhjetë një alfabetizim të plotë, gati 100% që është në nivelet e njëjta me ato të vendeve të industrializuara. Megjithatë përqindja e alfabetizimit të popullsisë në këto vite ka rënë në mënyrë të ndjeshme: më 1997 ishte 93%, më 2003 u ul në 79,5%.

Sinjalizohet që, përveç sistemit shkollor shtetëror, nga 1996 janë hapur shumë shkolla private, si të karakterit fetarë ashtu dhe laike. Këto janë shkolla të formimit të përgjithëshëm ose shkolla profesionale; në këto shkolla ka edhe kurse profesionale të ndryshme.



*Nxenes ne ditën e parë të shkolles*

Arsimi publik është falas; megjithatë shpenzimet financiare për arsimin nuk janë të mjaftueshme. Shkollat private laike o fetare janë të quajtura "alternative" dhe dallohen nga ato publike për karakterin e tyre profesional. Disa nga këto, janë të përfshira në sistemin publik.

Shkolla e detyrueshme përfshin një cikël i përbërë nga tetë vjetë që ndahen në dy nivele: fillore (klasa e I-IV) dhe tetëvjeçare (klasa e V-VIII). Në fund të klasës VIII bëhet provimi për mbylljen e ciklit të detyrueshëm. Reforma e 1990 e ka shtrirë arsimin e detyrueshëm, nga tetë në dhjetë vjetë, por ky provediment nuk është realizuar kurrë.


### 6.3. Punësimi dhe puna

Papunësia, që në teori nuk ekzistonte gjatë regjimit komunist, sot është nga më të lartat nga vendet ish-socialiste; ajo paraqet një tjetër aspekt të ndryshimeve ekonomike: ndërsa më 1990 rezultonin të punësuar 1433 mijë vetë, më 1993 të punësuarit zbritnin në 1063 mijë, ose 380 mijë të punësuar më pak vetëm në tre vjetë, me një përqindje të papunësisë 22%. Bëhet fjalë, në masë të gjërë të forcës punëtore të përjashtuar nga sektori i punës së krahut në rënie dhe i nëpunësve shtetërorë të shkarkuar në vazhdim të masave për lehtësimin e organeve të administratës publike. Situata erdhi duke u përmirësuar në vitet më pas. Përqindja e papunësisë zbriti në 18% më 1994 dhe në 12% më 1996. Kriza e 1997 nuk mund të mos rreflektohej dhe mbi punësimin, që bëri të rregjistrojë përsëri një rënie të fortë: në dhjetor të 1997 të papunët ishin mbi 193 mijë vetë, 35 mijë më shumë se viti i më parëshëm. Për të luftuar këtë fenomen, qeveria e re bëri, në shkurt të 1998, mori një grup masash për formimin profesional dhe për zhvillimin e iniciativave impreditoriale me qëllim që të krijojë, brënda 2001, 200 mijë vende të reja (një pjesë e qëllimit u arrit). Nga të dhënat e 2004 duket që papunësia, nga 14,4% më 2001, shkoi duke rënë në mënyrë progresive.

## **7. Komuniteti shqiptare ne Itali**

### **7.1 Emigrimet ne epoken historike**

Emigracioni shqiptare drejte brigjeve italiane nuk eshte nje fenomen i tanishem: dallgat e migrimit kane datohen '400, duke interesuar zona te shumeta te atehereshmen "mbreterine e Napolit" (ne te cilin Kalabria dhe Sicilija beshin pjese). Sipas studimeve historike, dallget migratore te Shqiptareve ne Itali kane qene tete. Emigrimi i pare merr daten e viteve 1399-1409 dhe i fundit te vitit 1774. Nje nga episodet e pare dhe shume te rendesishem te migrimit zhvillohet me 1448, kur nje grup ushtaresh epirot te kombesise shqiptare stabilizohet ndermjet Sicilise dhe Kalabrise mbasi kishin luftuar perbrinj Alfonsos I te Aragones, Mbret i Napolit. Ndjek me pas eksodi i udhehequr ndermjet 1459-1461 nga Gjergj Kastrioti Skenderbeu, qe kishte ardhur ne ndihme te Aragoneseve ne luften kunder Anxhioineve. Fluksi me i numert verifikohet pas vdekjes se Skenderbeut (1468) dhe me afrimin e Imperit Oktoman, qe detyroi nje pjese te madhe te popullsise shqiptare te shkoje ne mergim. per ti shpetuar skllavizimit dhe izlamizimit te forcuar. Migrime te tjeta verifikohen ne shekuj te ardhshem, drejt territorit te Mbreterise te Napolit



*Piktura ne mur qe raprezenton Scanderbeg qe kapercente "ujrat", e ruajtur ne nje kishë te komunitetit arberesh ne Italia*

Shqiptaret do te mbajne fene krishtere te rritit ortodoks dhe ky ishte , dhe eshte akoma, nje nga profilet me karakteristike te etnise shqiptare arbereshe duke e krahasuar me popullsine italiane dhe me popullsine shqiptare te mbetur ne shqiperi, te kthyer ne shumice ne myslyman.

Ne rrjedhjen e kohes, specialisht ne kete shekull, disa nga lokalitetet kane humbur perdorimin e gjuhes dhe karakteristika te tjera me origjine shqiptare. Aktualisht qendrat albanofone ne Itali, jane pak a shume pesedhete ne nje popullsi qe stimohet ne 100.000 persona, edhe se nuk mund te dihet shifra eksakte te italo-shqiptareve. E dhena e fundit e siguret statistikisht eshte ajo qe nxirret nga censimenti i fundit i 1921 nga i cili behet e ditur qe ata qe flasin shqip jane 80.282, shume me pak se 197 mije per te cilet flitej ne studimet e A. Freges te 1997<sup>9</sup>.

#### **7.1.1 Komunitetet arbereshe**

Komunitetet arbereshe jane sot te perhapura gati ne te gjithe Italine e jugut, duke tejkaluar pergjithesisht 100.000 persona, edhe se popullsia me origjine shqiptare qe flet gjuhen arbereshe perben nje pakice mbi teresine e perberies se komunitetit italo-shqiptare.

Kalabria eshte rajoni qe mban numerin e me te shumte te komuniteteve arbereshe: Komunitete te rendesishem jetojne ne te paketen 30 Komuna te rrethit, ne menyre te vecante ne province te Kosences.

Komuniteti me origjine shqiptare me i numert eshte ai Puliez edhe se akoma nje perqindje e ulet ( ne province te Foxhes, ne Kastelvekio, dhe ne Kieuti, dhe ne provincen e Tarantos ne San Marcano) flet akoma gjuhen arbereshe.

Komunitete te tjera gjenden ne Sicili ( veçanarishte ne Pianen e Shqiptareve), ne Molise (ne Komuna te Kampobasos, Ururi, Montecilfontes dhe Portocanones), ne Basilikate (ne Komuna te S. Paolos Shqiptare, S. Costantinos shqiptare, Bariles, Ginestres e Maschitos). Shume me te vogala Komunitetet italo-shqiptare ne Kampania dhe ne Abruco.

Arbereshet jetojne ne pergjithesi ne 41 Komuna dhe ne 9 Ndarje te ndara ne 7 rajone ne jug te Italise. Ekzistojne edhe 30 Komunitete te karakterizuara nga nje trashegimi te forte historike dhe kulturore arbereshe, por qe ka humbur, per motive te ndryshme, perdorimin e gjuhes shqiptare.

<sup>9</sup> Frega A., *Gli Arbëresh dimenticati*, in "Albania. Tutta d'un pezzo. In mille pezzi... e dopo?". Futuribili, n. 2-3, F. Angeli, Milano 1997.

Komunitete arbereshe te tjera te rendesishem gjenden ne zona te medha metropolitane, mbi te gjita ne Milano, Torino, Roma, Napoli, Bari, Kosenza, Krotone e Palermo.

Mbijetiojne komunitete te forta arbereshe, qe mbajne gjalte gjuhen dhe traditat e vendeve te origjines, ne Amerike: SH:B.A., Kanada, Argentine dhe Brasil.

### 7.1.2 Kultura arbreshe

Fjala arbereshe tregon dhe gjuhen e folur dhe emerit e shqiptareve te Italise, kurse Arberia percakton siperfaqen gjeografike te vendosjes se shqiptareve ne Itali.

Kultura Arbereshe, qe manifestohet tek traditat, tek kostumet, tek arti, tek astronomia, dhe te ruajtura akoma sot xhelozisht ne shume vende me tradita shqiptare.

### 7.1.3. Feja

Per sa i perket fese, Shqiptaret e Italise ndiqnin ritin bizantin ne gjuhe greke, te cilit papa Paolo II, ne 1536, i dha njohje te plote per brenda Katolicizmit. Shume komunitete shqiptare kane humbur, me rrjedhjen e shekujve, ritin grek-bizantin te origjines. Sot riti bizantin mbijeton ne komunitetet shqiptare te Provinces se Kosences dhe ne Piana te Shqiptareve, ne Sicili.

Pashket per Komunitetin italo-shqiptare te ritit grek-bizantin jane tema qendrore. Ruhen shume rite te lashta dhe perdorime simbolike si ajo e heqes se tendave nga dritarja e kishes te shtunen e shenjte ose ajo e grave qe, pas mesnates, ne shume vende, shkojne tek nje perrua jashte fshatit per ritin e “vjedhjes se ujit”.

Mengjesin e se dieles se Pashkeve behet funksioni i *auroras* ne fillim te se ciles, sagrestani, duke luajtur roline e djallit, mundohet te ndaloje hyrjen e priftit ne kishen, i cili pasi troket shume here hyne triumfal duke kenduar. Te henen dhe te marten ne shume komunitete arbereshe zhvillohen *vallet* tradicionale ne shesh.

Perkujtimi i te vdekurve nuk eshte ne nendor por ne fillim te praneveres, dhe merr karakteristikat e nje feste popullore, ne mes te ciles te vdekurit perzihen me te gjallet. Nje domethenie simbolike ne nder te te vdekurit kane *collivet*, feta buke me siper grur te zier. Ne mbremje miq dhe familiar hane darke bashke duke kujtuar, deri naten vone, te miredashurit dhe ruhet nje vend ne tryeze per te vdekurin. E shtuna tjetere eshte nje dite e nje trishrimi te thelle, sepse, sipas traditave, te vdekurit jane te detyruar te rikthehen neper varre.

Ne ritin grek-bizantin, nje rol qendror kane ikonat qe tregojne personazhe biblike, ne shendrim te statujave tipike te kishes katolike te ritit roman.

### 7.1.4. Gjuha.

Gjuha e folur nga shqiptaret e Italise eshte gjuha arbëreshe, perzierje e toskërishtes me gegërishten dhe e perzier gjate qendreses ne Itali. Llogaritet qe vetem 45% e fjalëve arbëreshe janë të përbashkta me gjuhën shqipe, qe një tjetër 15% paraqitet nga fjalë të reja të krijuara nga shkrimtarët italo-shqiptarë dhe mbetja eshte frut i perzierjes me italishten dhe dialektet lokale. Nje nga karakteristikat e veçanta të gjuhës arbëreshe eshte mungesa e fjalëve për të quajtur konceptet abstrakte, të zëvendësuar gjate shekujve nga huazime të gjuhës italiane.

### 7.1.5. Traditat popullore dhe folklori

Nje aspekt qe nenvizojme menjehere ne kulturën arbëreshe eshte rrespekti i thelle per mikun: sipas të drejtave morale të malësive të Shqipërisë, akoma dhe sot gjalle ne bashkësinë italiane, shtëpia e shqiptarit eshte e zotit dhe e mikut, i cili nderohet duke i dhene bukë, kripë dhe zemër. Nje tjetër aspekt qe rrjedh nga traditat popullore arbëreshe eshte kalimi i gjuhës vetem ndëpërmjet formës gojore.

Ne manifestimet e ndryshme të folklorit del ne pah gjithëmonë thirrja për atëdheun: ne këngët popullore ose fetare, ne legjendat, ne tregimet, ne proverbat, shquhet shpirti i bashkimit dhe i solidaritetit kombëtarë. Vetëdia i të qenurit nga një atëdhe i përbashkët, megjithëse të shpërndarë nëpër botë, eshte e dukshme ne fjalën qe thonë kur takohen dy shqiptarë qe mundë të perkthehet si: “gjaku ynë i shpërndarë”.

Temat kryesore të kulturës tradicionale shqipëtare janë malli për atëdheun e humbur, kujtimi për veprat legjendare të Skënderbeut, hero i njohur nga të gjithë shqipëtarët nëpër botë, dhe tragjedia e diasporës pas pushtimit turk.

Disa nga elementët në të cilët bazohet kultura e komunitetit shqipëtarë dhe që ruajnë akoma edhe sot janë: vatra, qendra kryesore rreth së cilës qëndron familja; “gjitonët”, domethënë komshinë, ambjenti i parë shoqërorë jashtë shtëpisë; “vëllamja”, vëllazëria; besa, besnikëria për fjalën e dhënë.

Një rëndësi të veçantë meriton vallja, kërcime popullore që bëhen në raste festash për të kujtuar fitoren e madhe të Gjergj Kastriotit Skënderbej kundër pushtuesve turq.

### 7.1.6. Veshjet

I një bukuri të veçantë janë veshjet tradicionale të grave që vishen në raste të veçanta si martesë ose festat e pashkëve ose të mbrojtësit të qytetit. Këto veshje janë kryevepra të vërteta artistike dhe pasqyrojnë simbolet antike nëpërmjet qëndisjeve të yjeve apo degëve të lulëzuara.

I famshëm për shkëlqimin dhe bukurinë është veshja tradicionale të Piana e Shqipëtarëve, në provincën e Palermos.

Shumë i bukur është edhe veshja tradicionale femërore në Costantino Albanese, e përbërë nga një mbulesë e kokës karakteristike, një këmbishë mëndafshi e bardhë me tantella, një jelek i kuq me mëngë të ngushta të qëndisura në ar dhe një fund në të cilin janë qepur tre shirita akllaz i bardhë dhe i verdhë.



*kostume tradicionale arberesh*

### 7.1.7. Mbrojtja e minorancave shqipëtare në Itali.

Në legjislaturën italijane, arbëreshët janë konsideruar si minorancë kombëtare “të një vendosje të vjetër”, që në bazë të ligjit 482 të datës 15 Dhjetor 1999 “ligjet në fushën e mbrojtjes së pakicave gjuhësore historike”, janë objekt mbrojtjeje. Ligji sheh ndër të tjera, futjen e gjuhës së pakicave, si lëndë studimi në shkollë.

## 7.2 Flukse emigratore aktuale.

Emigrimi jashtë vëndit, i shtypur gjatë regjimit komunist, shpërtheu me forcë duke filluar nga 1991, duke marrë karakteristikat e eksodit në masë. Data historike e eksodit shqipëtarë drejtë Italisë, është 7 Mars 1991, kur në një ditë hynë në portin e Brindizit 20 mijë refugjatë. Një eksod i dytë masiv drejtë Italisë u bë në muajin Gusht në të njëjtin vit kur rreth 10-12 mijë refugjat u grumbulluan në stadjumin “della vittoria” të Barit dhe më vonë i rikthyen.

Që atëhere, flukset e emigrantëve klandestin drejtë Italisë dhe Greqisë, kanë vazhduar gjithëmonë nëpërmjet Kanakit të Otrantos drejtë Italisë, duke u nisur nga Vlora, që tashmë e kishte kaluar Durrësin që ishte më parë qëndër kryesorë.

Sipas të dhënave të ministrisë së brëndshme italijane, më 26 Shtator 1996, kishin emigruar në Itali 57 mijë e 593 shqipëtarë të rregjistruar rregullisht. Me rastin e krizave politike dhe ekonomike të 1997, ndodhen valë të mëdha emigrimesh, të vlerësuara rreth 15-17 mijë vetë. Në këtë perjudhë, numri i emigrantëve shqipëtarë që kërkojnë dhe arrijnë të futen ilegalisht në Itali, është pakësuar në mënyrë shumë të ndjeshme në saj të patrullimit të përbashkët të motoskafëve të Guardia di Finanza italijane dhe shqipëtare dhe në sajë të akordeve qeveritare të bashkëpunimit

né këtë fushë të nënshkruar në 2000. Ndër të tjera shoqëri të shumëta jo qeveritare, si qendra ndërkombëtare e emigracionit kanë zhvilluar programe me bashkëpunimin e shtetit italian dhe shqipëtarë, për një emigrim lokal të popullsisë, sipas nevojave të forcës së punës për të cilat Italia ka nevojë në mënyrë periodike.

### **Sqarimet te dobishme**

**Viza:** në kufi (si tokësor, detarë, ajrorë), kur hynë kërkohet paghimi i dhjetë euro për vizën e detyrueshme dhe, në dalje, paghimi i dhjetë eurove (nuk paguajnë pashaportat diplomatike dhe ato të shërbimit).

**Rreziqet për shëndetin:** rreziqet më të mëdha shëndetësore paraqiten nga sëmundjet infektive gastrointestinale; është mirë të mos pihet ujë nga rrubineti (edhe pse ky është i pijeshëm) dhe të haet ku paguhet pakë; shërbimi në spitalet shtetërore është i mirë por kushtet e spitaleve janë të dobëta dhe të prapambetura me paisje të vjetra.

**Ndryshimi i orës:** një orë përpara në krahasim me meridianin e Grenviçit.

**Elektriciteti:** 220 W, 50 Hz.

**Peshat dhe matja:** sistemi me të dhjetat e metrit.

**Valuta lokale:** lek. 1euro=125 lek, por kudo mundë të paguash si në euro ashtu si dhe në dollarë.

## **Bibliografia**

### **Gjeografia**

- Ackerman E. A., *Albania. A Balkan Switzerland*, in "The Journal of Geography", vol. XXXVII, n. 7, 1938.
- Baldacci A., *Itinerari albanesi (1892-1902)*, Roma, 1917.
- Berxholli A., Qiriazi P., *Albania Aspectos Geograficos*, Tirana, Nentori, 1986.
- Blanc A., *Géographie des Balkans*, Paris, Puf, 1965.
- Bonasera F., *L'Albania. Aspetti geografici*, Herbita, 1981.
- Novelli G., *Fuga dall'Albania: perché?*, in Brusa C., *Immigrazione e multiculturalità nell'Italia di oggi*, Vol. I, Milano, F, Angeli, 1997, pp. 61-85.
- Vlora A.K., *La nuova Albania: lineamenti fisici, antropici ed economici*, Istituto Geografico Militare, Firenze, 1978.

### **Historia**

- Castellan G., *Histoire des Balkans (XIV – Xxe siècle)*, Paris, Fayard, 1991.
- Dell'Erba N., *Storia dell'Albania*, Roma, Newton & Compton, 1996.
- Falaschi R., *Ismail Kemal Vlora e l'indipendenza dell'Albania (1912). Memorie*, Bardi, 1992.
- Jelavich C. e Jelavich B., *The Establishment of the Balkan National States, 1804-1920*, Seattle-London, University of Washington Press, 1977.
- Pallotta G., *Storia di Skanderbeg, Principe degli albanesi*, Roma, 1958.
- Vickers M., *The Albanians – A Modern History*, London 1995.

### **Statistika dhe demografia**

- Qendra Shqiptare Per Studimin e Mergimit, *Database*, Tirana, 1996.
- Myrto H. *Albanesi alla porte. Documenti dell'esodo*, Manni, 1991.
- Pittau F., Reggio M., *Il caso Albania: immigrazione a due tempi*, in "Studi Emigrazione", n. 106, 1992.
- Resta P., *Un popolo in cammino. Le migrazioni albanesi in Italia*, Nardò (Lecce), Besa, 1996.
- Sivignon M., *La population albanaise: une ère nouvelle*, in "Méditerranée – Revue Géographiques des Pays Méditerranéens", n. 1-2, Aix-en-Provence, 1995.
- Thimm M. (a cura di), *Albanian Human Development Report 1996*, UNDP-United Nations Development Programme, Tirana, 1996.

### **Economia**

- Giurato L., *Albania: una transizione incompiuta*, in "Quaderni di Economia e Finanza" 1998.
- Gumbel A., *La bancarotta democratica*, in "Rive – Rivista di politica e cultura del Mediterraneo", n. 2, Roma 1997.
- Luci E., *Structural change in Albanian Economy*, Madison University of Winsconsin, 2003.
- Muco M. Minxhozi L., *Some issues and possibilities of a future economic cooperation in the balkan region: a comparative view*, in Bianchini S. Uvalic. M (a cura di) "The Balkans: the challenges of economic integration. Regional and European perspectives" Ravenna, Longo, 1997.

### **Kultura dhe shoqeria**

- Alia Z., *Familia dhe struktura e saje ne RPSH*, Tirana, Nentori, 1990.
- Di Paola G., *L'Albania odierna tra modernizzazione e tradizione. La rilevanza delle zone rurali*, Rapporto di ricerca, 1994.
- Hasluck M., *The unwritten law in Albania*, Cambridge, University Press, Cambridge 1954.
- Kauri M. E., *La condizione della donna*, in "Politica Internazionale – Dossier/Albania oggi: passaggio in Europa", n.3, Roma, 1994.
- Dammacco G., *Albania. Per capire una terra*, Lecce, Argo, 1993.

Del Re E. C., *Un paese in cerca di identità*, in Aa.VV., *Albania emergenza italiana*, in Quaderni speciali di Limes, 1997, pp. 53-58.  
 Lacirignola V., *Albania oggi*, Nardò (Lecce), Besa, 1994.  
 Maciotti M.I., Pugliese E., *Gli immigrati in Italia*, Bari-Roma, Laterza, 1991.  
 Morozzo della Rocca R., *Nazione e religione in Albania*, Nardò (Lecce), Besa, 1990.  
 Perrone L., *La presenza immigrata nelle regioni adriatiche. Il caso della Puglia*, in Melchionda U., *Gli albanesi in Italia*, Milano, F. Angeli, 2003, pp. 122-147.  
 Rulli G., *Dove va l'Albania?*, in "La Civiltà Cattolica", 2 marzo 1985.  
 Martelli F., *Capire l'Albania*, Bologna, Il Mulino, 1998.  
 Vaccaro A., Alenesia I., *Gli albanesi in Italia dal XVI secolo ad oggi*, Cosenza, Bios, 1994.  
 Perrone L., *Naufragi albanesi. Studi, ricerche e riflessioni sull'Albania*, Roma, Ed. Sensibili alle foglie, 1996.

### Shqiperia ne internet

<http://www.ios.com/~ulpiana/albanian/index.html>

Udhezues ne historine dhe kulturen Shqiptetare. permban *home page* te komunitetit shqiptetare ne bote.

<http://www.york.al.uk/~drh101albanian>

Albanian Resources Page. Udhezues i plote i siteve Internet per Shqipterine.

<http://www.worldweb.net/w1054/times.html>

Albanian Times. Lajme javore per Shqipterine.

<http://www.tirana.al>

Tirana Freenet. Siti i pare Internet i vendosur ne Shqipteri. Lajme ekonomike dhe sherbime.

<http://web.albanianews.com/albanianews>

lajme te perditeshme reth Shqipterise.

<http://www.telpress.it/ata>

Siti i Agjensise Telegrafike Shqiptetare.

<http://www.albania.co.uk/dp/>

Siti il Partise Demokratike.

<http://www.albanian.com/main/news/index.html>

Udhezues i siteve Internet dhe stampes mbi Shipterine me adresa e-mail.

<http://www.unicef.org/infobycountry/albania-statistics>

Informazione mbi te dhena statistike te Shqipterise

<http://www.cestim.it/dossier.paesi/albania.htm>

Udhezues i informazionit gjeografik, historik, social, ekonomik dhe riferimente Raportesh, Studimesh, Volume dhe links qe flasin per Shqipterine.

<http://www.iomtirana.org.al>

Organizacjon Internacjonal i Migrimit ne Shqipteri.